

**PROJEKTI I EDUKIMIT
TË VOTUESVE PËR HERË TË PARË**

**EDHE UNË
VOTOJ !**



**MANUAL PËR ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN
11 MAJ 2025**

EDHE UNË VOTOJ !

Botim i Akademisë së Studimeve Politike në kuadër të programit *“Edhe unë votoj – Edukimi i votuesve për herë të parë 2025”*, pjesë e projektit të Këshillit të Evropës *“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve në Shqipëri”*, financuar nga Republika Federale e Gjermanisë.

Përmbajtja

Shqipëria jonë	4
Për çfarë do të votoj	5
Sistemi zgjedhor që përdorim	7
Ku do të votoj	9
Procesi i votimit	11
Mos lejo të tjerët të vendosin për ty	15
Përgjegjësitë dhe sanksionet	16
Aplikacioni mobile për zgjedhjet	19

4 minuta për 4 vitet e ardhshme !

Të dashur të rinj

Ky manual informues u drejtohet të gjithë të rinjve që votojnë për herë të parë në zgjedhjet për Kuvend në 11 maj 2025.

Nëpërmjet këtij botimi shpresojmë që ju të njihni më mirë jo vetëm procedurën e votimit, por njëkohësisht edhe rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë process.

Ju do të vendosni për kandidatët që do të përfaqësojnë zërin dhe vullnetin tuaj për çdo zhvillim apo shqetësim që ndikon në mirëqenien tuaj dhe të komunitetit ku ju banoni.

Nëse i kushtoni vetëm 4 minuta leximit të këtij manuali, do të keni mundësinë që të njiheni më mirë me procesin zgjedhor dhe rëndësinë e votës suaj për 4 vitet e ardhshme të zhvillimit të vendit.

I. Shqipëria jonë

Shqipëria njihet zyrtarisht si **Republika e Shqipërisë që nga viti 1992**. Shqipëria është anëtare e Kombeve të Bashkuara, NATO-s, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Këshillit të Evropës, Organizatës Ndërkombëtare të Tregtisë, Organizatës së Konferencës Islamike dhe një nga anëtarët themeluesë të Bashkimit për Mesdheun. Pas plotësimit të një sërë procesesh të integritimit, prej marsit 2020 vendi ynë ka nisur negociatat e pranimit si vend anëtar në Bashkimin Evropian.

Republika e Shqipërisë është demokraci parlamentare e themeluar në bazë të kushtetutës së rinovuar në vitin 1998 me referendum popullor, duke garantuar kështu shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut e lirinë fetare.

Autoriteti i Qeverisë mund të burojë vetëm nga vullneti i qytetarëve të saj, i cili shprehet nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të mbajtura në intervale të rregullta, mbi bazën e votimit universal, të barabartë dhe të fshehtë.

Zgjedhjet janë një parakusht për të siguruar një demokraci përfaqësuese, por përtej tyre, nevojitet një angazhim i vazhdueshëm i qytetarëve për të garantuar transparencë dhe vendimmarrje në interes të qytetarëve. Roli i shoqërisë civile, grave dhe të rinjve, si dhe nevoja themelore për një ndryshim paqësor të udhëheqësve në pushtet, përbëjnë një faktor thelbësor për konsolidimin e demokracisë.



II. Për çfarë do të votoj ?

Zgjedhjet për Kuvend mbahen çdo katër vjet për të përcaktuar 140 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë që do të përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve në katër vitet e ardhshme. Njëkohësisht, partia apo koalicioni që fiton nga këto zgjedhje më shumë se gjysmën e mandateve të deputetëve të Kuvendit (70 + 1 mandate) fiton të drejtën për të krijuar qeverinë që do të drejtojë vendin. Kjo e drejtë u jepet qytetarëve vetëm një herë në katër vite dhe ata duhet ta shfrytëzojnë me përgjegjësinë e duhur këtë mundësi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni i mandatuar nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili ka për detyrë të organizojë të gjithë procesin zgjedhor si edhe të shpallë rezultatin e zgjedhjeve dhe mandatojë deputetët. Të drejtat dhe detyrat e KQZ përcaktohet nga ligji themelor i zgjedhjeve, apo ndryshe i quajtur Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

Reforma zgjedhore ka përcaktuar ndryshime të rëndësishme në procesin e votimit në këto zgjedhje për të mundësuar zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Risi - Për herë të parë do të votojnë nëpërmjet shërbimit postar edhe shqiptarët që jetojnë jashtë vendit apo ndryshe Diaspora. Mbi 245.000 shqiptarë me të drejtë vote janë regjistruar në sistemin e KQZ për të ushtruar të drejtën e votimit nga vendet ku ata jetojnë.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Ilirjan Celibashi gjatë zhvillimit të një mbledhjeje.

Foto: LSA

III. Sistemi zgjedhor që përdorim

Në këto zgjedhje votohet sipas sistemit proporcional me konkurrim rajonal. Vendi është ndarë në 12 zona zgjedhore, që përkrijnë me ndarjen territoriale të qarqeve dhe në secilën prej këtyre zonave është përcaktuar një numër i caktuar mandatesh. Numri i deputetëve për çdo qark/ zonë zgjedhore përcaktohet në përpjestim me numrin e banorëve të tij dhe në këtë mënyrë çdo deputet përfaqëson një numër të përafërt qytetarësh në të gjitha qarqet.

Lista e shpërndarjes së mandateve në qarqe:

Nr.	Qarku/ zona zgjedhore	Mandate
1	Berat	7
2	Dibër	5
3	Durrës	14
4	Elbasan	14
5	Fier	16
6	Gjirokastrë	4
7	Korcë	10
8	Kukës	3
9	Lezhë	7
10	Shkodër	11
11	Tiranë	37
12	Vlorë	12
	Totali	140

Subjekte zgjedhore mund të jenë:


- Parti politike
- Koalicion partish politike (me një listë dhe logo të përbashkët)
- Kandidat i propozuar nga një grup votuesish

Subjektet zgjedhore duhet të paraqesin përpara ditës së votimit, një listë shumëemërore të kandidatëve të përcaktuar prej tyre në secilin zonë zgjedhore (qark) të vendit. Në përfundim të votimit, mbi bazën e votave të marra për secilin subjekt, bëhet edhe shpërndarja e mandateve për kandidatët e listës së paraqitur.

Listat e hapura – Vota preferenciale

Në këto zgjedhje mundësohet e ashtuquajtura listë e hapur e kandidatëve. Zgjedhësit mund të japin votë parapëlqyese për 2/3 e kandidateve në listat e paraqitura nga subjektet zgjedhore. Kandidatët më të votuar në këtë listë shumëemërore “të hapur” mund të renditen fitues të mandateve të përfituara nga partia e tyre, përtej listës “së mbyllur” (1/3), pavarësisht renditjes fillestare.

Kodi Zgjedhor detyron subjektet që për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë përqind e listës shumëemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Vakancat e krijuara në rast tërheqje nga mandati duhet të zëvendësohen nga e njëjta gjini. Ky rregull synon që të krijojë mundësinë e përfaqësimit sa më të drejtë të kandidateve të gjinisë femërore në lista zgjedhore dhe më tej në Kuvend.




IV. Ku do të votoj?

Çdo qytetar shqiptar që ka mbushur 18 vjeç deri në ditën e votimit (duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve), ka të drejtë për të votuar e për t'u zgjedhur, pavarësisht nga raca, etniciteti, gjinia, gjuha, bindja politike, besimi fetar, aftësitë fizike, apo kushtet ekonomike.

Autoritet vendore kanë detyrimin që t'iu njoftojnë paraprakisht me shkrim në lidhje me qendrën e votimit, vendndodhjen e saj, adresën, si dhe numrin rendor të votuesit në listën e votuesve.

Përpara ditës së votimit duhet të siguroheni që emri juaj gjendet në listat e votimit të shpallura publikisht në ambjentet publike pranë njësisë suaj të banimit apo në **aplikacionin mobile KQZ** Android/IOS, në faqen zyrtare të internetit **www.kqz.gov.al** dhe portalit e-Albania në rubrikën Kërkimi i Qendrës së Votimit.

Në rast se ju nuk e gjeni emrin tuaj në listat e publikuara apo identiteti juaj ka pasaktësi, duhet të njoftoni Zyrën e Gjendjes Civile të zonës tuaj. Gjithashtu keni të drejtë të paraqisni një kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore.



Votimi dhe identifikimi elektronik

Identifikimi elektronik i zgjedhësve do të jetë i mundur në të gjitha qendrat e votimit. Një pajisje identifikuese elektronike do të vendoset në çdo Qendër Votimi, duke lexuar letërnjoftimin ose pasaportën tuaj. Nga leximi do të shfaqen: qendra juaj e votimit, të dhënat tuaja si dhe foto përkatëse. Pas verifikimit, votuesi duhet të vendosë shenjën e gishtit në pajisje si një konfirmim i mëtejshëm i identitetit.

Të dhënat e marra nga pajisja elektronike do të ruhen fizikisht në të sipas standardeve më të larta të sigurisë. Pas përfundimit të numërimit të votave si dhe përfundimit të afatit të ankesave nga subjektet zgjedhore, të dhënat e votuesve do të asgjësohen.


Në këto zgjedhje votimi dhe numërimi elektronik do të zbatohet në të gjitha qendrat e votimit të Njësisë Administrative nr. 10 të Bashkisë Tiranë (31 qendra votimi) dhe qendrat e votimit të Bashkisë Vorë (44 qendra votimi). Në të gjitha zonat e tjera të votimit në vend do të zbatohet votimi dhe numërimi manual.

Si mund të votojmë

1. Duke qëndruar vetëm në kabinën e votimit, votuesi shënon me një "X" ose "+", apo edhe shenjë përbri emrit të subjektit dhe kandidatit që preferon në listën e paraqitur. Duhet patur kujdes që shenja të jetë brenda kuadratis bosh të parashikuar përkrah subjektit.
2. Zgjedhësi palos fletët në kabinën e votimit me qëllim që të mos shihet për cilin është votuar, por të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës të jetë e dukshme.
3. Zgjedhësi shkon për të depozituar fletën e votimit në kutinë e votimit dhe del më pas nga qendra e votimit.
4. Nëse fleta e votimit plotësohet jashtë kabinës së votimit, votuesit nuk i lejohet të depozitojë fletën e votimit në kuti dhe ajo do të quhet e PAVLEFSHME.
5. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit pa dashje dhe kërkon një fletë votimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi e dytë. Nëse e përsërit këtë kërkesë për herë të dytë, atij nuk i jepet më fletë votimi.

**Kujdes, fotografimi i votës është vepër penale
dhe dënohet deri në 3 vite burgim.**

Skema e mëposhtme shpjegon të gjitha hapat që duhen ndjekur në Qendrën e Votimit.



Zgjedhësit më aftësi ndryshe

E drejta e votimit iu garantohet detyrimisht edhe personat me aftësi ndryshe. Në këtë rast:

1. Zgjedhësi mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.
2. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
3. Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.
4. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në dhe kjo e fundit pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi që i lejojnë ata të votojnë në mënyrë të pavarur. Në rast të kundërt, këta zgjedhës mund të shfrytëzojnë të drejtën për t'u asistuar sipas procedurës së mësipërme për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

VI. Mos lejo të tjerët të vendosin për ty!

Zhvillimi i një shoqërie demokratike në Shqipëri ende nuk është i plotë. Një problem i vazhdueshëm është 'votimi familjar' në të cilin një pjesëtar i familjes – zakonisht kryefamiljari – vendos ose ndikon zgjedhjen e votimit për pjesëtarët e familjes.


Kjo ndodh nëpërmjet:

- Votimit në grup (hyrja në kabinën e votimit së bashku me pjesëtarë të tjerë të familjes),
- Votimit të hapur (grupet familjare votojnë së bashku hapur) dhe
- Votimit të deleguar (marrja e fletëve të votimit 'në emër' të pjesëtarëve të familjes).

Votimi i fshehtë përbën një tipar themelor të procesit demokratik. Kjo praktikë ndikon në të drejtën për të shprehur vullnetin individual si qytetarë dhe kryesisht prek gratë. E drejta për të zgjedhur me votim të fshehtë i përket çdo individ dhe është e parashtruar në ligj.

Një tjetër fenomen i kufizuar, por mjaft i dëmshëm është dhe shitja dhe blerja e votës së qytetarëve. Duke pranuar një shpërblim të vogël financiar, qytetarët humbasin mundësinë për të sjellë ndryshim me votën e tyre. Për fat të keq, fenomeni i shitblerjes së votës ndikon edhe në shtrembërimin e rezultatit të zgjedhjeve dhe forcën e votës së të gjithë qytetarëve të tjerë për të ndryshuar partitë dhe udhëheqësit politikë në pushtet.

Ndikoni që në familjen tuaj të mos votohet në grup, apo të mos delegohet dhe shitet vota, por secili prej pjesëtarëve të shprehet lirshëm për vullnetin e tij.



VII. Përgjegjësitë dhe sanksionet

Pjesëmarrja në zgjedhje është një e drejtë, por njëkohësisht përbën edhe një përgjegjësi. Nëse zgjedhësit shkelin detyrimet apo bëhen pjesë e veprimeve, të cilat synojnë shtrembërimin e rezultatit të zgjedhjeve, atëherë ata rrezikojnë që të bëhen subjekt i ndëshkimeve të parashikuara si më poshtë vijon:

- Pengimi me çdo mënyrë i subjekteve zgjedhore apo kandidatëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit me qëllim ndryshmin e rezultatit të zgjedhjeve, ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Kur falsifikimi kryhet nga persona që kanë për detyrë të administrojnë procesin zgjedhor dhe shoqërohet me pasoja të rënda. **DENOHET NGA 3 - 7 VITE BURG**

- Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje i çdo materiali tjetër zgjedhor - **DENOHET NGA 6 MUAJ - 5 VITE BURG**
- Kur dëmtimi kryhet nga personat përgjegjës për administrimin zgjedhor ose në bashkëpunim dhe ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e zgjedhjeve - **DENOHET NGA 3 - 8 VITE BURG**
- Fotografimi apo filmimi i votës, që ta shfaqësh tek persona të tjerë. **DENOHET NGA 3 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Kur shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit kryhet nga personat e ngarkuar me zgjedhjet. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Nxitja, detyrimi me ose pa shpërblim i zgjedhësit për të shkelur rregullat që garantojnë fshehtësinë e votimit. **DENOHET NGA 1 - 4 VITE BURG**
- Votimi më shumë se një herë, me mjete identifikimi të rreme apo të zgjedhësve të tjerë. **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Lejimi me dashje i votimit më shumë se një herë nga komisionerët zgjedhorë. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Lejimi me dashje nga komisionerët zgjedhorë i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Kërkimi ose pranimi nga zgjedhësi i të hollave, të mirave materiale, ose favorizimeve të tjera për të marrë pjesë ose jo në votime. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Kanosja që i bëhet zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Kur kanosja apo përdorimi i dhunës që i bëhet komisionerit, vëzhguesit, numëruesit si dhe çdo zyrtari tjetër në kryerjen e detyrës. **DENOHET NGA 1 - 4 VITE BURG**
- Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë. **DENOHET NGA 2 - 5 VITE BURG**

- Pengimi i zgjedhësit për të votuar në qendrën e tij të votimit, duke shkelur rregullat e votimit. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**
- Kur kjo vepër kryhet më shumë se një herë. **DENOHET NGA 3 - 7 VITE BURG**
- Dhënia e dokumentit të identifikimit personave të tjerë për të votuar. **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Marrja e dokumentit të identifikimit shtetasve të tjerë për të ndikuar në votim me qëllime të paligjshme. **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Pjesëmarrja e një punonjësi të administratës shtetërore në aktivitete ose fushatë zgjedhore në kundërshtim me ligjin **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Detyrimi ose organizimi i nxënësve të arsimit parauniversitar për të marrë pjesë në fushatë nga punonjës në arsimin publik dhe jopublik **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Detyrimi ose kërkesa nga punonjës që kryen një detyrë shtetërore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore, ose për të votuar në një mënyrë caktuar **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një subjekti zgjedhor. **DENOHET NGA 1 - 3 VITE BURG**
- Shpërdorimi i autoritetit ushtarak për të influencuar në votime tek ushtarakët e tjerë me dhënie urdhërash, apo çdo propagande tek vartësit. **DENOHET NGA 6 MUAJ - 3 VITE BURG**
- Shpërdorimi i autoritetit policor nga punonjësi i Policisë së Shtetit ose i Policisë së Burgjeve për të influencuar në votime me dhënien e urdhrave, apo çdo propagande tek vartësit. **DENOHET NGA 1 - 5 VITE BURG**

Mos hezitoni të denonconi parregullsitë zgjedhore pranë portalit të denoncimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor në adresën <https://kqz.gov.al/denonco> ose nëpërmjet aplikacionit mobile KQZ për telefonat smartphone. Mund të zgjidhni të mbeten anonim, por denoncimi do të shqyrtohet në rast se e keni shprehur sa më qartë dhe me të dhëna. Denoncimet tuaja do të ndiqen më pas nga organet e drejtësisë, mes të cilave edhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

VIII. Aplikacioni mobile për zgjedhjet

Të rinjtë përdorues të telefonave mobile Android dhe iPhone mund të informohen në kohë reale mbi procesin e zgjedhjeve, por edhe për të denoncojnë rastet e abuzimeve me të drejtën e votimit nëpërmjet aplikacionit "KQZ". Nëpërmjet këtij aplikacioni mund të realizohet:

- Edukimi interaktiv mbi procesin zgjedhor dhe të drejtat dhe detyrimet e votuesve;
- Informacion mbi qendrën e votimit dhe udhëzimi me hartë online se ku ndodhet qendra;
- Raportim në kohë reale përmes imazheve dhe videove për abuzime, presione apo shit-blerje të votës duke ruajtur anonimitetin e denoncuesit;
- Informacion të përditësuar mbi rezultatet e numërimit të votave dhe kandidatët fitues.

Aplikacioni mund të shkarkohet falas në platformat përkatëse të aplikacione për Android dhe iPhone.

Mbi të gjitha mos harroni:

Ditën e zgjedhjeve keni një takim të rëndësishëm.

Një takim me të ardhmen.

EDHE UNË
VOTOJ !